

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-14169

Dt. 07.06.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Bekim (Ramiz) Bellanica** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare me etazhitet fazë P+1 dhe lokal me etazhitet P+0, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesit: Bekim (Ramiz) Bellanica nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim - objekt i banimit individual – shtëpi familjare, dhe lokali i punës, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-9784/17, të datës 19.05.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 205/2, Z.K. Jahoc, në rrugën “Vëllëzërit Abdullahu”, në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit, me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit – shtëpisë familjare është P+1, ndërsa etazhitetit i lokalit është P+0, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit **S=289.39 m²**.

Përdhesa banim:	(Sip,Bruto):	S= 150.02 m²
Përdhesa lokal:	(Sip,Bruto):	S= 136.00 m²
Kati i parë banim:	(Sip,Bruto):	S= 103.37 m²

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual, dhe lokali, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja për shërbime të inxhinieringut, projektimit dhe ndërtimit “HARP” - Gjakovë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Bekim (Ramiz) Bellanica nga Gjakova, me banim në rrugën “Vëllëzërit Abdullahu” nr.44, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-14169 të datës 02.06.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare me etazhitet fazë P+1 dhe lokal me etazhitet P+0, në ngastrën kadastrale me nr. 205/2, Z.K. Jahoc, në rrugën “Vëllëzërit Abdullahu”, në pronësi të lartë përmendurit, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 29.03.2017, të punuar nga NSH”Geogauss”- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 24.05.2017 në pronësi të Bekim Bellanica, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me nr. të lëndës 2663/17 të datës 24.05.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimi për Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/01-9784/17 të datës 19.05.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 205/02 ZK: Jahoc, të lëshuar nga DUMM.
5. Deklaratë Noteriale me nr.LRp.Nr.1808/2017, dt.24.05.2017.
6. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr. 08-320-01-13509, dt.26.05.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
7. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr. 430-I-727 të datës 02.06.2017.
8. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, të datës 25.05.2017.
9. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”, Sh.A.Gjakovë, nr.1088 të datës 14.04.2017.
10. Pëlqimin nga PTK - Gjakovë, datë 23.05.2017.
11. Vërtetimin nga KRM”Çabрати”, me nr.479, dt.26.05.2017.
12. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në TEB-SH.A., filiali në Gjakovë me datë 07.06.2017.
13. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, ndërmarrja për shërbime të inxhinieringut, projektimit dhe ndërtimit “HARP” - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1283.30 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për punë Inspektuese,
- Arhivës.

Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.

U.D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.

Parc. nr. 205-2

[illegible]

Punoi:
Fatmir Bobi tek.

Vërtetohet urb.
Durrëje Berishaj.D.A.

Punoi : N.SH "Geogauss" Gjakovë
DREJTORI
Xhelil Tertini gjeom.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GJAKOVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Jahoc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-70705037-00205-2	Pracelë / Parcela / Parcel	327,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:500

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 24.05.2017

Koha/ Vreme/ Time: 08:59:46

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: MCO GJAKOVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

